



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 93/1 Prot.

Tiranë, më 16.01.2024

V E N D I M

Nr. 19, Datë 16.01.2024

Bazuar në nenin 33/11, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O N:

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në ndryshuar, është regjistruar ankesa nr. 135, datë 29.06.2023, e K.V, i përfaqësuar nga Avokate S.P¹ kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes familjare”.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gjerat “a”, “ç”, nenit 33, pikat 11-15 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën dhe i janë ofruar mundësitë, që të jepte shpjegime dhe dokumentacion për ankesën sipërcituar, në mënyrë që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kishte mundësi të shqyrtonte këtë ankesë. Komisioneri konstaton se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me dijeninë e plotë nuk ka ofruar bashkëpunim dhe nuk ka dhënë informacionin dhe dokumentet e kërkuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në vijim të procedurave të shqyrtimit të çështjes, me shkresat: nr. 771/4, datë 26.09.2023 dhe nr. 771/5, datë 19.10.2023, Komisioneri i është drejtuar DPPSH, duke kërkuar informacion lidhur me arsyet pse kandidati është i papërshtatshëm për vijimin e studimeve në Akademinë e Sigurisë.

Në vijim, DPPSH, pavarësisht faktit që ka marrë dijeni 2 (dy) herë, lidhur me shkresat e sipërcituara, nuk ka depozituar asnjë dokument apo parashtrim lidhur me sa ka kërkuar Komisioneri, në kuadër të shqyrtimit të ankesës në fjalë.

¹ Referuar Prokurës së Posaçme, nr. repertori 774, nr. koleksioni 329, datë 08.06.2023, të noterit E. P. B.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në pamundësi të një informacioni të detajuar dhe verifikimit të dokumentacionit të kërkuar, është vënë në situatën e pamundësisë për të arritur në konkluzionin mbi trajtimin e pafavorshëm të shtetasit K.V.

Në këtë kuadër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në vijim të shqyrtimit të çështjes, me Vendimin nr. 03, datë 08.01.2024, ka dënuar me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë për mosdhënien e informacionit të nevojshëm për shqyrtimin e çështjes, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Me shkresën nr. 134, datë 11.01.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka dërguar pranë Komisionerit, informacionin e kërkuar sipas Vendimit nr. 03, datë 08.01.2024.

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 33/11, “..... Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”, Komisioneri arrin në përfundimin se ka në dispozicion informacionin e kërkuar për të vazhduar shqyrtimin e çështjes.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 33/11 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e Vendimit nr. 03, datë 08.01.2024.
2. Vazhdimin e procedurës së shqyrtimit të ankesës nr. 135, datë 29.06.2023, të K.V.
3. Të njoftohen palët për këtë vendim.

KOMISIONERI

Robert GAJDA